

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Rahovecit 2012

Dhjetor, 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Problemet në Komunën e Rahovecit .....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Rahovecit .....	6
4. Investimet kapitale .....	11
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik .....	13
6. Administrata e Komunës së Rahovecit .....	14
7. Arsimi në Komunën e Rahovecit .....	15
8. Shëndetësia në Komunën e Rahovecit.....	17
9. Transparenca në Komunën e Rahovecit.....	18
10. Burimet.....	20

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Rahovecit udhëhiqet nga z. Smajl Latifi i ardhur në këtë pozitë si kandidat i AAK-së pas dorëheqjes së Qazim Qeskes (PDK). Gjatë vitit 2011 dhe 2012, Komuna e Rahovecit është karakterizuar me një qeverisje më dinamike, por e manifestuar në disa raste me shpërfillje të normave ligjore, dyshimeve për keqpërdorim të pronës komunale si dhe shpenzimeve të larta në disa kategori.

Komuna e Rahovecit ka shpenzuar për telefon gjatë vitit 2011 me shumë së Komuna e Lipjanit, Malishevës dhe ajo e Drenasit.

Komuna e Rahovecit më shumë shpenzon për naftë brenda një viti se sa për energji elektrike, ku bëjnë pjesë rryma e shpenzuar për objektet komunale, ndriçimi publik, objektet shëndetësore, shkollat, çerdhja si dhe objektet tjera të ngjashme.

Të dhënat tregojnë se në këtë komunë që nga pas lufta ekziston e ashtuquajtura ' mafia e tokës' e cila funksionon në zinxhir mes Gjykatave – Komunës dhe personave të tretë që mund të jenë individë apo kompani të caktuara. Në fshatin Xerxë nga gjithsej 25 hektar tokë që ka pasur komuna (tokë publike apo komunale) aktualisht komuna në atë lokacion ka më pak se 2 hektar tokë, pjesa tjetër është e tjetërsuar dhe është transferuar në tokë private, përmes vendimeve të gjykatave disa prej të cilave të nxitura edhe nga vetë Komuna.

Nga të dhënat zyrtare vihet në pah një rritje e ndjeshme në shumë kategori të shpenzimeve brenda linjës buxhetore për mallra dhe shërbime. Kësisoj, për telefon mobil dhe fiks, Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 7.258 euro më shumë se një vit më herët, ndërsa tek blerja e naftës për ngrohje 25.544 euro janë shpenzuar më shumë në krahasim me vitin paraprak. Rritje të shpenzimeve hasen edhe në kategorinë e blerjes së druve dhe thëngjillit, marrë së bashku në këto blerje gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 22.473 euro më shumë se një vit më herët. Rritje të shpenzimeve ka pasur edhe në kategorinë e publikimeve dhe botimeve ku diferenca mes vitit 2010 dhe atij 2011 është për 8.226 euro më shumë në vitin 2011. Rritje të theksuar haset edhe tek kategoria e blerjes së kompjuterëve, blerjes së ushqimit dhe pijeve, në shërbimet teknike e kështu me radhë. Kategoria ku haset rënie e ndjeshme e shpenzimeve është ajo për dreka dhe darka zyrtare, ku gjatë vitit 2010 janë shpenzuar 18.835 euro më shumë se një vit më vonë (2011). Njëkohësisht rënie janë evidentuar edhe tek kategoria e mirëmbajtjes dhe servisimit të veturave, përkatësisht gjatë vitit 2010 në këtë kategori ka pasur mbi 11.000 euro më shumë shpenzime se një vit më vonë.

Pas ardhjes në krye të Komunës të z. Smajl Latifit, disa zyrtarë komunal janë përjashtuar e disa të tjerëve u është ndryshuar pozita. Në të gjitha rastet, kryetari ka refuzuar t'i përfillë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Një rast i tillë është ai i zyrtares Fitnete Kasapi, e cila është përjashtuar nga

puna në fund të vitit 2011. Edhe pse gjykata ka vendosur në favor të saj, Kryetari refuzon rikthimin e saj.

## 1. Hyrje

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veri-perëndimore dhe llogaritet t'i këtë afërsisht 276 kilometra katror. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave kjo komunë ka rezultuar t'i këtë 56.208 banorë. Kjo komunë gjatë tri viteve të kaluara ka mbajtur dy palë zgjedhje lokale. Në zgjedhjet e para të rregullta të zhvilluara në fund të vitit 2009 zgjedhjet për Kryetar komune i fitoi Qazim Qeska si kandidat nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Pas 11 muajsh të ushtrimit të mandatit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, Qazim Qeska pati dhënë dorëheqje nga pozita e të parit të komunës duke i njoftuar për këtë mediat, kryesinë e degës së PDK në Rahovec si dhe Këshillin e Drejtorëve të Komunës së Rahovecit. Por, kryesia e degës së PDK nuk e pat mbështetur dorëheqjen dhe pas intervenimit të krerëve të PDK, Qazim Qeska u rikthye në detyrën e Kryetarit të Rahovecit, 47 ditë pas dorëheqjes. Presidenca e Kosovës për këtë rast iu pat adresuar Gjykatës Kushtetuese për të interpretuar nëse Qazim Qeska mund të ushtrojë edhe më tutje pozitën e të parit të Komunës. Gjykata Kushtetuese pati konstatuar se rikthimi në pozitën e kryetarit të komunës pas dorëheqjes paraqet shkelje të Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.<sup>1</sup> Pas këtij vendimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) shpalli mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Komunën e Rahovecit më 18 dhjetor 2010. Zgjedhjet u zhvilluan në dy raunde. Në balotazh fitues doli Smajl Latifi (AAK), i cili fitoi 53% të votave, ku për kundërshtar kishte Ibrahim Kryeziun (LDK).

Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, zgjedhjet i fitoi si kandidat i AAK, pas kalimit të tij në këtë parti nga Lëvizja për Bashkim (LB). Dy muaj pas marrjes së mandatit të Kryetarit të Rahovecit, Smajl Latifi tërhiqet nga dega e AAK në Rahovec dhe vazhdon të ushtrojë funksionin e Kryetarit pa mbështetje politike të asnjë subjekti partiak në këtë komunë. Asamblistët e AAK në Kuvendin Komunal mbajnë qëndrim opozitar kundruall ekzekutivit komunal dhe Kryetarit të saj.

Kuvendi Komunal i Rahovecit përbëhet prej 31 përfaqësuesve nga parti të ndryshme, ku dhjetë prej tyre janë asamblistë të PDK, shtatë nga LDK, pesë nga AAK, katër AKR, një LDD, një PD dhe dy asamblistë janë nga Lëvizja për Bashkim. Anëtarët e KK të Rahovecit janë zgjedhur në zgjedhjet e nëntorit 2009, për dallim nga Kryetari i cili është zgjedhur në janar të 2011.

Komuna e Rahovecit njihet si lokalitet bujqësor. Kjo komunë vlerësohet për cilësinë e rrushit dhe verërave që prodhon. Prej vitit 1990 deri në vitin 1999, pjesë e Komunës së

---

<sup>1</sup> Gjykata Kushtetuese. Aktgjykim nr. KO 80/10. Burimi: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/aktgjykim\\_rasti%20nr\\_80\\_10\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/aktgjykim_rasti%20nr_80_10_shq.pdf)

Rahovecit ishte edhe Malisheva. Qeveria e përkohshme (e vitit 1999) pat marrë vendim që ta formojë përsëri komunën e Malishevës, duke e shkëputur atë nga komuna e Rahovecit.

Ky raport mbulon zhvillimet rreth politikave publike në Komunën e Rahovecit për periudhën janar 2011 – tetor 2012. Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët e Rahovecit, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi dhe transparencën e Komunës.

## **2. Problemet në Komunën e Rahovecit**

Përveç problemeve të papunësisë dhe zhvillimit të ulët ekonomik, banorët e Komunës së Rahovecit përballen edhe me problemin e pamundësisë së shitjes së prodhimeve bujqësore (rrushit), mungesës së parkingjeve në qytet, cilësisë së dobët të rrugëve, mos gëlqerosjes dhe mirëmbajtjes së ndërtesave publike. Gjithashtu, shumë zona të kësaj komune përballen me mungesë të kanalizimit, ujit të pijes, rrezikut nga vërshimet si dhe problem i vazhdueshëm mbetet eksploatimi i rërës nga lumenjtë e kësaj ane.

Komuna e Rahovecit është e njohur për kultivimin e hardhive të rrushit. Në vitet e fundit është evidente pamundësia e vreshtarëve për të shitur rrushin tek operatorët e përpunimit të tij. Kjo ka sfiduar interesimin e vreshtarëve për të investuar në këtë lami. Problematikë rezulton të jetë edhe mungesa e kanaleve për ujitjen e vreshtave. Komuna ka bërë disa investime në këtë drejtim, por kanë rezultuar të jetë të pamjaftueshme. Rendimentet jo të kënaqshme të rrushit këtë vit besohet të kenë ardhur nga thatësia dhe mungesa e kanaleve të ujitjes.

Komuna e Rahovecit nuk ka arritur akoma që të përmbyllë fazën e investimeve esenciale në territorin e saj. Janë rregulluar dhe asfaltuar vetëm rrugët kryesore, por jo edhe ato anësore. Mbi 300 kërkesa të lagjeve, zonave dhe vendbanimeve tjera janë adresuar gjatë vitit 2012 në Drejtorinë e Shërbimeve Publike me qëllim të rregullimit të rrugëve me kubëza të betonit. Për këtë qëllim gjatë këtij viti kanë qenë të ndara 45.000 euro, çka do të thotë se kapacitetet buxhetore të komunës nuk premtojnë zgjidhjen e shpejtë të këtij problemi.

Autoritetet lokale në Rahovec nuk kanë arritur të zgjidhin problemin nga mungesa e parkingjeve në qytet. Ndonëse në këtë komunë funksionojnë dy auto parkingje, njëri publik e tjetri privat, banorët detyrohen të ecin rrugës së automjeteve, ngase automjetet janë të parkuara nëpër trotuare.

Problem tjetër në Komunën e Rahovecit janë edhe mbeturinat e pa grumbulluara në qytet dhe fshatrat përreth. Vetëm në qendër të qytetit vërehen të vendosura shporta për hedhjen e mbeturinave të imta, ndërsa në periferi nuk vërehet asnjë e tillë. Në periferi

dhe fshatrat e kësaj komune kohë pas kohe krijohen deponi të egra mbeturinash. Në Komunën e Rahovecit funksionojnë dy kompani private për bartjen e mbeturinave dhe kompania publiko-regjionale "Ambienti". Shkalla e pagesës së mbeturinave nga ana e qytetarëve vlerësohet të jetë tejet e ulët, gjë e cila sipas zyrtarëve po shkakton edhe telashe në menaxhimin efikas të mbeturinave në zonat urbane dhe rurale të kësaj komune.

Problem tjetër që e ka përcjellë në vazhdimësi Komunën e Rahovecit është rreziku i daljes nga shtrati i lumenjve. Lumi Dullo i cili kalon përgjatë qytetit të Rahovecit, si dhe nëpër disa fshatra si Çiflag, Celinë, Dejë, Fortesë, shpesh ka shkaktuar përmytje duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në shtëpi të banimit dhe në të mbjellat bujqësore. Për më tepër, ky lum shërben edhe si vend-derdhje e ujërave të zeza dhe mbeturinave. Komuna ka nisur këtë vit ta rregullojë një pjesë të lumit Dullo, por vetëm pjesën e cila e përshkon qytetin. Komuna e Rahovecit përpos Lumit Dullo ka probleme edhe me lumin Drini i Bardhë. Problemet me Drinin e Bardhë vijnë si pasojë e gërryerjes së pakontrolluar të zhavorrit. Ndërkohë, fshatrat pranë lumit, sidomos fshatrat Kromovik dhe Ronaj, mbeten nën mëshirën e lumit duke vazhduar të jenë të rrezikuara nga vërshimet.

Mungesa e ujit të pijes për qytetarët mbetet problem i vazhdueshëm. Ndonëse në qytet dhe rrethinë nuk vërehet mungesë e madhe e ujit të pijes, kjo nuk ngjet edhe me fshatrat e kësaj ane. Fshatrat që akoma nuk kanë as sistem të ujësjellësit janë: Drenovci, Senovci, Pastasela, Palluzha, Qifllak, Kramovik, Guri Kuq, Kaznik, Zatriq dhe Reti. Komuna e Rahovecit furnizohet me ujë të pijes nga hidrosistemi i Radoniqit të Gjakovës dhe nga disa burime nëntokësore. Këto burime janë në Zaqishte dhe Apterushë.

Pjesa dërmuese e rrugëve të qytetit të Rahovecit janë pa sistem të ndriçimit publik. Po ashtu përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve të qytetit hasen ndërtesa të pa gëlqerosura dhe të pa mirëmbajtura. Problem serioz në Rahovec paraqitet mungesa e pronës komunale në brendi të qytetit. Komuna pothuajse nuk ka askund prona komunale nën menaxhim brenda qytetit, faktor ky që pamundëson planifikimin dhe investimin në projektet me interes publik. Problem për qytetarët paraqet edhe mungesa e këndeve rekreative për fëmijët si dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara.

### **3. Performanca buxhetore e Komunës së Rahovecit**

Komuna e Rahovecit ka nisur vitin 2011 me një borxh të trashëguar nga qeverisja një vjeçare e ish Kryetarit të Komunës Qazim Qeska. Afro 1 milionë euro ka qenë shuma e borxhit që kjo komunë ka pasur si obligime financiare të papaguara ndaj operatorëve privat dhe kompanive publike në vend. Në fillim të vitit 2012, shkalla e borxhit publik ka qenë 277.936 euro, vlerë kjo që tregon për rënien e shumës së borxhit total, por akoma mbetet në nivel të lartë, kur merret parasysh kapaciteti i përgjithshëm buxhetor.

Shkalla e të hyrave komunale në këtë komunë ka shënuar rritje në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010. Ndërsa shuma totale e të hyrave gjatë vitit 2012 është e njëjtë me shumën e mbledhur gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Tabela nr.1: Të hyrat komunale në Rahovec gjatë katër viteve të fundit

Viti	2009	2010	2011	2012 (9 muaj)
Shuma (euro)	771.000	781.000	887.000	511.441

Nga tabela e mësipërme vihet në pah një rritje e të hyrave në vitin 2011 në shumën e 106.000 eurove në krahasim me një vit me herët. Kjo rritje e të hyrave ka ardhur kryesisht nga mbledhjet e borxhit nga tatimi në pronë si dhe nga gjobat e shqiptuara në trafik.

Sipas të dhënave të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili i referohet vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka zbrazëti dhe mangësi serioze në menaxhimin dhe grumbullimin e të hyrave komunale. Kësisoj, sipas këtij institucioni, Komuna e Rahovecit nuk ka arritur të paraqes një listë të veçantë e të detajuar të debitorëve të tatimeve dhe taksave. Pa të dhëna të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë buxhet të besueshëm dhe të saktë si dhe të bëjë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur. Për më tepër, sipas ZAP, kontrollet e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme të të ardhurave dhe programet dhe sistemet e faturimit rrisin rrezikun e manipulimit të shifrave dhe keqpërdorimit të informatave.<sup>2</sup>

Komuna e Rahovecit tërheq grant nga niveli qendror duke supozuar numrin e popullsisë në 63.000 banorë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës rezultatet e regjistrimit të popullsisë tregojnë se kjo komunë ka rreth 7.000 banorë më pak se numri i supozuar për grante, çka do të thotë se nga fillimi i vitit 2014 kur fillon ndarja e granteve në bazë të numrit të regjistruar të popullsisë, Komuna e Rahovecit do të marrë një grant më të vogël se ai i gjertanishmi.<sup>3</sup>

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Rahovecit është afro 9.8 milionë euro. Prej tyre 887.000 euro janë të hyra komunale, ndërsa pjesa tjetër transferohet nga niveli qendror.

<sup>2</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Rahovecit. 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Rahovec\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_928872.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Rahovec_31_12_2011_Final_alb_928872.pdf)

<sup>3</sup> Instituti për Studime të Avancuara GAP. Regjistrimi i Popullsisë dhe ndikimi i tij në Politikat Publike. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Rahovecit për 2012

Kategoria	Shuma (euro)
Investime kapitale	3.280.936
Mallra dhe shërbime	750.564
Subvencione dhe transfere	100.000
Shpenzime komunale	277.758
Paga dhe mëditje	5.305.700
<b>Gjithsej</b>	<b>9.714.958</b>

Komuna e Rahovecit nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ka ulur shpenzimet në disa kategori, por ka shënuar rritje shpenzimesh në disa kategori tjera. Ulja më e madhe e shpenzimeve është hasur në kategorinë e drekave dhe darkave zyrtare, ndërsa rritje kanë shënuar kategoritë për telefona, derivate për vetura dhe gjenerator, blerje të druve dhe thëngjillit, botime dhe publikime e kështu me radhë.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa kategori gjatë vitit 2011 dhe krahasimi me vitin 2010

Kategoria	Shuma	
	2010	2011
Shpenzime për telefon	14.771	22.029
Furnizim i zyrave	61.714	65.035
Furnizim me ushqim dhe pije	7.525	11.554
Dreka zyrtare	24.821	5.986
Blerje e naftës	116.614	142.158
Naftë për gjenerator	5.027	10.118
Derivate për vetura	59.106	59.998
Mirëmbajtje të automjeteve	26.932	15.889
Botime dhe publikime	7.544	15.770
Blerje e druve për ngrohje	33.519	46.450
Blerje e thëngjillit për ngrohje	27.490	37.032
Blerje e kompjuterëve	7.777	25.462
Shërbime teknike	2.703	5.185
Shërbime të kontraktuara	00	204.644

Nga të dhënat e mësipërme vihet në pah një rritje e ndjeshme në shumë kategori të shpenzimeve brenda linjës buxhetore për mallra dhe shërbime. Kësisoj, për telefon mobil dhe fiks, Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 7.258 euro më shumë se një vit me herët, ndërsa tek blerja e naftës për ngrohje 25.544 euro janë shpenzuar më shumë në krahasim me vitin paraprak. Rritje të shpenzimeve hasen edhe në kategorinë e blerjes së druve dhe thëngjillit, marrë së bashku në këto blerje gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 22.473 euro më shumë se një vit më herët. Rritje të shpenzimeve ka pasur edhe në kategorinë e publikimeve dhe botimeve ku diferenca mes vitit 2010 dhe atij



2011 është për 8.226 euro. Rritje të theksuar haset edhe tek kategoria e blerjes së kompjuterëve, blerjes së ushqimit dhe pijeve, në shërbimet teknike e kështu me radhë. Kategoria ku haset rënie e ndjeshme e shpenzimeve është ajo për dreka dhe darka zyrtare, ku gjatë vitit 2010 janë shpenzuar 18.835 euro më shumë se një vit më vonë (2011). Njëkohësisht rënie janë evidentuar edhe të kategoria e mirëmbajtjes dhe servisimit të veturave, përkatësisht gjatë vitit 2010 në këtë kategori ka pasur mbi 11.000 euro më shumë shpenzime se një vit më vonë.

Për nga numri i popullsisë, Komuna e Rahovecit është e përafërt me Komunën e Drenasit, Lipjanit dhe Malishevës. Krahasimi i shpenzimeve në disa kategori mes këtyre komunave e nxjerrin Rahovecin të parën për nga shifra e shpenzimeve.

Tabela. nr.4: Krahasimi i shpenzimeve për telefoninë fikse dhe mobile mes Komunës së Rahovecit dhe tri komunave të përafërta - 2011

Komunat	Shuma (euro)
Rahovec	22.029
Drenas	19.763
Lipjan	16.014
Malishevë	18.161

Trendi në rritje i shpenzimit të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe gjatë nëntëmujorit të këtij vitit 2012. Sipas raporteve zyrtare rezulton se në shumë kategori ka pasur rritje të shpenzimeve, krahasuar me nëntë mujorin e vitit të kaluar 2011.

Tabela nr.5: Shpenzimet në disa kategori gjatë nëntë muajve të këtij viti 2012 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar - 2011

Kategoria	Shuma	
	2011	2012
Furnizim i zyrave	8.103	35.090
Dreka zyrtare	1.350	1.891
Derivate për vetura	28.186	44.529
Mirëmbajtje të automjeteve	5.825	10.655
Botime dhe Publikime	6.828	6.940

Komuna e Rahovecit më së shumti shpenzime rezulton të ketë për naftë të cilat dedikohen për ngrohje, vetura zyrtare si dhe për gjeneratorë. Nëse merren shifrat e përgjithshme të shpenzuara për derivate të naftës, atëherë del që kjo komunë më shumë shpenzon për naftë brenda një viti se sa për energji elektrike, ku bëjnë pjesë rryma e shpenzuar për objektet komunale, ndriçimi publik, objektet shëndetësore, shkollat, çerdhja si dhe objektet tjera të ngjashme.

Tabela nr.6: Krahasimi i shumës së parave të shpenzuara për energji elektrike dhe atyre për karburante në Komunën e Rahovecit -2011

Kategoria	Shuma (euro)
Shpenzimet për naftë	212.264
Shpenzimet për rrymë	161.245

Nga 161.245 euro të shpenzuara për energji elektrike nga Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2011, 27.073 euro janë shpenzuar nga QKMF dhe qendrat tjera shëndetësore në Rahovec, ndërsa 26.499 euro janë shpenzuar nga shkollat fillore, ato të mesme dhe nga çerdhja e qytetit. Shifra prej 161.245 eurove të shpenzuara për energji elektrike është për mbi 15.000 euro më shumë se sa shpenzimet në të njëjtën linjë gjatë vitit 2010. Po ashtu edhe shpenzimet për ujë janë më të larta në 2011 se sa një vit më herët. Gjatë vitit 2010 për ujë janë shpenzuar nga Komuna e Rahovecit 32.443 euro, ndërsa gjatë 2011, 37.972 euro. Rënie të shpenzimeve në vitin 2011 ka pasur për pagesat e mbeturinave, gjatë atij viti (2011) për mbeturina janë paguar gjithsej 58.983 euro, apo 14.195 euro më pak se një vit më herët.

Nëse i llogarisim shpenzimet për energji elektrike të bëra nga ana e QKMF-së dhe punkteve shëndetësore në bazë të ditëve të vitit, atëherë rezulton se afro 75 euro në ditë janë shpenzuar energji elektrike nga këto qendra, ndërsa marrë në total Komuna e Rahovecit për energji elektrike gjatë një dite shpenzon afro 442 euro, apo 161.245 euro gjatë vitit.

Shuma është dukshëm më e lartë nëse llogarisim shpenzimet për naftë dhe derivate të naftës në bazë të 365 ditëve të vitit. Kësisoj, rezulton se Komuna e Rahovecit për një ditë shpenzon 581 euro për naftë. Gjatë një viti, administrata komunale, shkollat dhe institucionet tjera ndërlidhëse punojnë 280 ditë, për shkak të pushimeve gjatë vikendeve dhe festave të parapara. Nga kjo rezulton se shuma e shpenzuar për derivate duhet llogaritur mbi bazën e 280 ditëve, çka do të thotë se shpenzimet për naftë brenda një dite dalin të jenë 758 euro.

Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 75.940 euro për rregullimin e trafave të rrymës dhe rrjetit elektrik. Këto investime, ndonëse të nevojshme për vendbanimet e Rahovecit, nuk do të duhet të bëheshin nga ana e komunës, ngase përgjegjës për zgjerimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit elektrik është Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe jo komunat.

Kryetari i Komunës së Rahovecit në fund të vitit 2011 ka shpërblyer me nga një pagë shtesë gjithë drejtorët e drejtorive dhe rreth 30 zyrtarë të tjerë komunal. Arsyetimi për ndarjen e këtyre parave është bërë duke u thirrur në punën shtesë. Komuna asnjëherë nuk e ka rregulluar këtë çështje me akte përcjelljese juridike si udhëzime, urdhëresa, rregullore apo vendime përkatëse, ku lejohet dhe autorizohet puna shtesë dhe në bazë të saj të bëhet kompensimi. Po ashtu partitë opozitare në Kuvendin e Rahovecit kanë

kërkuar nga ekzekutivi që të i'u dërgohet një raport ku argumentohet se sa orë kanë qenë këta persona të angazhuar jashtë orarit, në cilët sektorë kanë qenë të angazhuar dhe në cilën periudhë. Ky raport nuk i është dërguar Kuvendit nga ana e ekzekutivit. Përveç kësaj në arsyetimin e dhënies së këtyre parave është thënë se paguhen shërbyesit civil të komunës për punët jashtë orarit, por drejtorët e drejtorive të komunës nuk mund të vlerësohen dhe kategorizohen si shërbyes civil. Ndarja e këtyre mjeteve përveç që rezulton të jetë pa bazë ligjore dhe të jetë bërë në mënyrë jo të rregullt, ajo ka shkaktuar edhe polemika dhe ndarje në mes të shërbyesve civil, një pjesë e të cilëve janë ndjerë të përjashtuar dhe të nënvlerësuar.

## 4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Rahovecit nga fillimi i vitit 2011 kanë pasur një shtrirje të gjerë, ndonëse kjo komunë mbetet akoma larg përmbushjes së nevojave të qytetarëve për rregullimin e rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësit, proçkave të ujit e kështu me radhë.

Tabela nr. 7: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Rahovecit të realizuara gjatë vitit 2011

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Rregullimi i rrugës për fshatin Apterushë	89.114
Asfaltimi i rrugës në relacionin Zoqishtë - Reti	167.000
Rregullimi i trotuareve në fshatin Fortesë	25.279
Rregullimi i rrugëve në lagjen "Gashi" si dhe në lagjen e Romeve në fshatin Krushë e madhe	36.675
Rregullimi i rrugës në relacionin për Çifllak	67.542
Rregullimi i rrugës në fshatin Patiçan i Ulët	50.233
Instalimi i kanalizimit në fshatin Drenoc	39.275
Ndërtimi i kolektorit për fshatrat Hoqë e vogël dhe Brestoc	88.710
Ndërtimi i rezervarit të ujit për qytetin e Rahovecit	48.753
Rregullimi i shtratit të lumit Rimnik	344.142
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Gexhë	9.940
Rregullimi i përroit në fshatin Ratkoc	9.900
Rregullimi i rrugëve në lagjet e epërme të Rahovecit	15.956

Cilësia e punëve të kryera në infrastrukturën e Komunës së Rahovecit paraqitet e dobët. Ka disa raste që pak kohë pas përfundimit të projekteve shfaqen dëmtime dhe deformime të ndryshme. Shembull për këtë shërben rruga në relacionin Zeqist -Reti e cila është rregulluar në shtator të vitit 2011, ndërsa është dëmtuar në pranverën e vitit 2012.

Gjatë nëntëmujorit të këtij vitit (2012) investimet kapitale janë fokusuar kryesisht në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në periferi të qytetit të Rahovecit dhe fshatave të kësaj komune.

Tabela nr 8.: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Rahovecit të realizuara gjatë nëntëmujorit të këtij vitit - 2012

<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Senoc	46.143
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Reti - 'Faza e dytë'	59.283
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Fortesë	17.620
Rregullimi i rrugës Apterush - Reti	118.070
Rregullimi i rrugës në lagjen "Shkelzen Zllanoga"	86.143
Rregullimi i rrugës në lagjen "Sakip Bellaqa"	60.000
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Vrajak	106.705
Rregullimi i kanalizimit në Dabidol	108.702
Ndërtimi i trotuarit në Kramavik	33.390
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Brestoc	55.863
Rregullimi i rrugës në lagjen "Agim Qelaj"	40.000
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Hoqë e Vogël	86.797
Meremetimi i shesheve kryesore të qytetit	27.440
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Bratatin	56.714
Rregullimi i rrugës në relacionin Pataqan - Noshpall	95.463
Rregullimi i lumit Duhllo	1.277.966,50
Rregullimi i rrugës në lagjen "28 nëntori"	140.000
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Zatriq	70.440

Nga tabelat e mësipërme vihet në pah se në vitin 2011 dhe gjatë periudhës së gjertanishme të këtij viti, pjesa më e madhe e projekteve në sferën e investimeve kapitale janë fokusuar në zonat rurale të kësaj komune. Kjo është adresuar si kritikë edhe në Kuvendin Komunal të Rahovecit ndaj ekzekutivit, por këta të fundit i kanë mbrojtur këto investime me pohimin se në vazhdimësi pas lufte është investuar në zonat urbane dhe kësaj deri vonë kanë mbetur anash investimet në zonat rurale. Projekti më i madh i investuar në zonat urbane gjatë dy viteve të kaluara është ai për rregullimin e shtratit të lumit të quajtur Dullo ku vlera e investimeve është afro 1.3 milion euro.

Nga gjithë bashkëbiseduesit në Rahovec është pohuar se në këtë komunë që nga pas lufta ekziston e ashtuquajtura 'mafia e tokës' e cila funksionon në zinxhir mes Gjykatave - Komunës dhe personave të tretë që mund të jenë individë apo kompani të caktuara. Kësaj në fshatin Xerxë nga gjithsej 25 hektar tokë që ka pasur komuna (tokë publike apo komunale) aktualisht komuna në atë lokacion ka më pak se 2 hektar tokë, pjesa tjetër është e tjetërsuar dhe është transferuar në tokë private, përmes vendimeve të gjykatave, të nxitura edhe nga komuna. Rasti i fundit i ngjarë në këtë drejtim ka

ndodhur pas ardhjes në krye të komunës të kryetarit aktual Smajl Latifi. Kësisoj, Kryetari i Komunës ka shkarkuar dhe përjashtuar nga puna avokaten publike në komunë Fitnete Kasapi (në fund të 2011) dhe në vend të saj e ka caktuar Ymret Reshiti për të përfaqësuar interesat e komunës në gjykatat e vendit. Në vendimin për emërimin e tij është thënë se personi në fjalë (Ymret Reshiti) ka të drejtë të lidh marrëveshje në emër të komunës me palët në kontest. Rasti ka të bëjë me një serb lokal të Rahovecit i quajtur Zoran Gergoviç të cilit në vitin 1958 autoritetet e atëhershme i kanë marrë një patundshmëri (arë, mal, lëndinë, vresht) dhe ai ka aluduar që nuk ka qenë i kompensuar për atë tokë në sipërfaqe të përgjithshme prej 79 ari. Toka që i është marrë ka qenë në vendin e quajtur Potoqani i naltë. Në vitin 1996, Zoran Gergoviç merr një vendim nga gjykata e atëhershme e Rahovecit për kthimin e tokës së mëhershme nën pronësinë e tij, por autoritetet komunale serbe të Rahovecit të asaj kohe (1996) refuzojnë ta përfillin këtë vendim me arsyetimin se është i pabazë. Pastaj me datë 24.03.2011, Zoran Gergoviç i drejtohet prapë gjykatës në Rahovec, por kësaj radhe për të shikuar mundësinë e një marrëveshjeje me Komunën e Rahovecit. Avokat i Zoran Gergoviçit ka qenë Qazim Qeska, ish Kryetari i dorëhequr i Rahovecit. Në seancën gjyqësore me nr të dosjes 17/2011 të mbajtur në Prill dhe Maj 2011 lidhur me kërkesën e fundit të Gergovic interesat e Komunës së Rahovecit i ka përfaqësuar Ymret Reshiti. Ky i fundit i thotë trupit gjykues se është në interes të Komunës plotësimi i kërkesës së z. Gergovic dhe se komuna është e gatshme që përmes një marrëveshjeje gjyqësore t'i jep z. Gergovic atë që kërkon pa pasur nevojë që lidhur me kërkesën e tij të vendos gjykata. Ymri Reshiti gjatë seancave të mbajtura për këtë rast (proces verbalet janë siguruar nga GAP) i drejtohet gjykatës me fjalët se kjo çështje duhet të zgjidhet, ngase në vendin që do ta marrë Gergoviçi do të ndërtohet një biznes i madh dhe me interes për komunën. Dilema që lind është se si e ka ditur z. Reshiti epilogun e krejt këtij kontesti, sepse në parcelën që i është dhënë Gergoviçit po pretendohet të ndërtohet një qendër tregtare nga persona privat të përkatësisë shqiptare. Vlera aktuale e tokës që i është marrë Gergoviçit maksimalisht mund të shitet 300 euro për ari, ndërsa toka ku komuna i kanë dhënë si kompensim Gergoviçit në zonën industriale të Xerxes ka vlerën 3.500 eurove për ari, pra 78.62 ari tokë e cila sipas tregut aktual ka vlerën prej 275.000 eurove. Menjëherë pas marrjes së tokës nga Gergoviçi, ai ia ka shitur tokën një personi në Rahovec dhe aktualisht pritet që në atë zonë të ndërtohet një qendër tregtare.

## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Rahovecit fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organogramit funksionin brenda Zyrës së Kryetarit. Kjo zyre ka gjithsej tre të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Menaxherit të Zyrës së Prokurimit. Gjatë vitit 2011 nëpërmjet kësaj zyre janë lidhur 111 kontrata duke u bazuar në procedurat e prokurimit publik, ndërsa vlera e këtyre kontratave ka qenë 5.184.854,01 euro.

## 6. Administrata e Komunës së Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka gjithsej 177 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë zjarrfikësit dhe të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale. Ndërsa së bashku me sektorin arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sferën e shëndetësisë, numri i të punësuarve në Rahovec është gjithsej 1.143 persona.

Tabela nr.10: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Rahovecit

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	15
Drejtoria e Administratës	43
Drejtoria e Inspektionit	12
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	13
Drejtoria për Shërbime publike dhe emergjenca	24
Zyra për Komunitete	9
Drejtoria për Bujqësi	9
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	4
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	10
Drejtoria e Urbanizimit	5
Drejtoria e Shëndetësisë	17
Drejtoria e Arsimit	5
Drejtoria për Kulturë	11
<b>Gjithsej</b>	<b>177</b>

Pas ardhjes në krye të Komunës të Smajl Latifit, disa zyrtarë komunal janë përjashtuar e disave të tjerë u është ndryshuar pozita. Në të gjitha rastet kryetari ka refuzuar t'i përfillë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kësisoj, zyrtarja Fitnete Kasapi është përjashtuar nga puna në fund të vitit 2011. Ajo ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM) dhe në Gjykatën Komunale në Rahovec dhe të dy këto instanca në vendimet e tyre e kanë obliguar komunën që Fitnete Kasapi të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, por kryetari kategorikisht refuzon të përfill këto vendime. Rasti i zyrtares Fitnete Kasapi tani është adresuar në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

Kryetari refuzon të përfill edhe vendimin e KPM në rastin e të punësuarve Ilir Haxhijaha dhe Nystrete Sokoli të cilëve u janë ndërruar koeficientet e pagës si rezultat i ndërrimit të pozitës së punës.

Konkurset për zyrtar për informim, zyrtar ligjor, zyrtar protokolli dhe udhëheqës personeli në Komunë të Rahovecit janë shpallur menjëherë në javën e parë pas ardhjes së kryetarit Smajl Lafiti në detyrë. Në këto vende janë zgjedhur njerëzit e preferuar të



kryetarit, si Qemajl Krasniqi – zyrtar për informim, Isak Hoti – zyrtar ligjor, Jetullah Kabashi – udhëheqës i Prokurimit dhe Ymret Reshiti – udhëheqës i personelit. Dy të parët (Qemajl Krasniqi dhe Isak Hoti) kanë shkuar në punë që nga dita e parë kur ka filluar edhe kryetari Smajl Latifi. Ymret Reshiti me vonë caktohet u.d. avokat komunal.

Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të mbajtur në fund të muajit tetor të këtij viti, ekzekutivi ka propozuar një rregullore për riorganizimin e administratës komunale dhe përcaktimin e vendeve të punës, pozitës, rolit dhe funksionit të tyre. Në këtë rregullore të propozuar, ekzekutivi ka paraparë edhe pozita të cilat nuk hasen në komunat e tjera, si për shembull zyrtar i lartë për çështje të sigurisë, zyrtar për ndërlidhje me ambasadat ndërkombëtare në vend e kështu më radhë. Kjo rregullore është refuzuar të votohet nga ana e asamblistëve komunal me arsyetimin se bie ndesh me ligjet e aprovuara nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Ekzekutivi komunal i Rahovecit përbëhet nga 11 Drejtori dhe 7 zyre. Dy drejtori udhëhiqen nga femrat, përkatësisht Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Arsimit.

## **7. Arsimi në Komunën e Rahovecit**

Në sferën e arsimit të Komunës së Rahovecit gjatë vitit 2011 dhe dhjetëmujorit të këtij viti 2012 ka pasur përparime të dukshme dhe kjo vërehet veçmas në fushën e infrastrukturës, ku disa shkolla janë ndërtuar rishtas, janë riparuar disa sosh dhe pothuajse në të gjitha objektet arsimore ka pasur investime të cilat kanë ndikuar në avancimin e kushteve në fushën e arsimit për këtë komunë. Por problemet në fushën e arsimit mbeten serioze për këtë komunë. Raportet zyrtare të prezantuara nga ana e Drejtorisë së Arsimit e paraqesin me shqetësim ekzistimin e numrit të vogël të punonjësve në Drejtorinë e Arsimit e cila problematikë reflekton në kufizimin e mundësisë për monitorimin dhe menaxhimin efikas të fushës së arsimit në Komunën e Rahovecit. Nga të dhënat e mësipërme për të punësuarit në administratë vërehet se numri i të punësuarve në Drejtorinë e Arsimit është gjithsej shtatë persona, kaq sa ka edhe Zyra Komunale për Komunitete. Përderisa Drejtorja e Arsimit ka shtatë të punësuar, Drejtorja e Kadastrit ka 12 të punësuar ajo e Bujqësisë 10 të punësuar. Sektori i bujqësisë dhe ai i kadastrit do të mund të mbulohej me një numër me të vogël të punësuarish, përderisa Drejtorja e Arsimit do të duhet të kishte një numër me të madh, ngase edhe sasia e punëve gjatë një dite konsiderohet më e madhe në krahasim me drejtoritë tjera.

Në raportin vjetor të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Rahovecit për vitin 2011 ceken një mori problemesh të cilat sipas kësaj Drejtorie kanë pamundësuar apo vështirësuar progresin në sferën e arsimit në Komunën e Rahovecit. Njëri ndër problemet më të mëdha llogaritet numri i madh i mungesave të nxënësve, por edhe të mësimdhënësve gjatë kohës së mësimi. Problem tjetër që vlerësohet në rritje paraqitet braktisja e

shkollës nga ana e nxënëseve. Nga ana tjetër mosfunksionimi i duhur i zyrës së prokurimit, për shkak të mangësisë në personel, si dhe çështja e mos aprovimit të buxhetit nga niveli qendror, kanë bërë që zgjidhjet e problemeve të marrin më tepër kohë dhe të përcillen me probleme serioze. Raporti i Drejtorisë së Arsimit vlerëson negativisht edhe nivelin profesional të stafit brenda kësaj Drejtorie si dhe shumëllojshmërinë e punëve brenda ditës, gjë kjo e cila pamundëson rezultate pozitive në disa fusha.

Investimet në infrastrukturën e arsimit në Komunën e Rahovecit gjatë vitit 2011 dhe gjashtëmujorit të parë të këtij viti kryesisht kanë qenë në meremetimin e objekteve, gëlqerosjen e tyre, rregullimin e rrethojave, mirëmbajtjen dhe sigurimin e objekteve si dhe në transferimin i sistemit të ngrohjes. Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka investuar në ndërtimin e një shkolle fillore në fshatin Malësi e Vogël në vlerë prej 748.950 euro, ndërsa Komuna e Rahovecit ka ndërtuar dy shkolla fillore, një në fshatin Polluzhë (në dy faza) me kosto të ndërtimit 276.869 euro dhe tjetra është ndërtuar në të ashtuquajturën zona e gurit të kuq, vlera e investuar ka qenë 179.381 euro.

Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 objekte të shkollave fillore, një çerdhe dhe tri shkolla të mesme. Në çerdhen e qytetit janë të sistemuar afro 50 fëmijë, ndërsa të punësuar janë tetë persona, katër prej tyre edukatore, ndërsa katër të tjerë punojnë në cilësinë e ndihmësit.

Tabela nr.11: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 33 shkollat fillore të Rahovecit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	213	5
Meshkuj	376	101
<b>Gjithsej</b>	<b>589</b>	<b>106</b>

Tabela nr.12: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në shkollat e mesme të Rahovecit:

Gjinia	Numri i mësimdhënësve	Stafi ndihmës
Femra	36	1
Meshkuj	79	19
<b>Gjithsej</b>	<b>115</b>	<b>20</b>

Tabela nr.13: Numri total i mësimdhënësve, nxënëseve dhe stafit ndihmës në 33 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme në Komunën e Rahovecit

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	704	249	455
Nxënës	13.301	6.356	6.945
Stafi ndihmës	126	6	120



## 8. Shëndetësia në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka nën menaxhim një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), gjashtë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe dy punkte shëndetësore apo ambulanca. QKMF gjendet në qendër të qytetit, ndërsa në periferi janë dy ambulanca. QMF janë të shtrira në zonat rurale të kësaj komune, një e tillë gjendet në fshatin Çifllak, Drenoc, Fortesë, Apterushë, Malësi e Vogël dhe një në fshatin Brestovc.

Specifikë e Komunës së Rahovecit për dallim nga komuna tjera të vendit në fushën e shëndetësisë është që kjo komunë posedon me disa reparte të rëndësishme shëndetësore të cilat nuk mund të hasen në komunat tjera, përjashtimisht në ato komuna ku ekziston spitali rajonal, i cili është nën menaxhimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo të komunave. Kështu në QKMF e Rahovecit funksionon reparti i maternitetit, shërbimi për fizioterapi si dhe dispenseri kundër tuberkulozit. Përveç kësaj, në QKMF ofrohen edhe shërbime stomatologjike, pediatrike, gjinekologjike, imunizimit, rëntgenit, internistike, urologjike si dhe analiza bio-kimike. Përveç institucioneve shëndetësore publike në Rahovec ofrojnë shërbime rreth 15 klinika private nga të cilat 13 janë të përqendruara në Rahovec dhe dy janë në fshatrat e kësaj ane.

Personeli mjekësor përbëhet nga 125 të punësuar, prej tyre 22 mjekë, 68 infermierë, 35 personel ndihmës. Numri i mjekëve të përgjithshëm dhe atyre të specializuar është i pamjaftueshëm dhe kjo përbën një brengë serioze për ecurinë e përgjithshme në sferën e shëndetësisë në Rahovec.

Drejtoria e Shëndetësisë në raportet e saja zyrtare adresuar Kuvendit të Rahovecit potencon një mori problemesh të cilat e përcjellin sektorin e shëndetësisë në këtë komunë. Kësisoj, njëri ndër problemet e para të cekura në raportin e punës për vitin 2011 është evidentimi i shpenzimeve të mëdha në rrymë dhe naftë nga ana e qendrave mjekësore, pastaj mungesa e personelit mjekësor, mungesa e pajisjeve mjekësore, organizimi jo i mirë i punës në sektorët përkatës dhe mos respektimi i orarit të punës në disa vende, mungesa e materialit shpenzues në stomatologji, barërat ampulare emergjente, material sanitar, material reagensë shpenzues për laborator, material higjienik dhe materiali administrativ, pajisjet mjekësore të vjetruara. Përveç këtyre, Drejtoria e Shëndetësisë problem e ka vlerësuar edhe mos zbatimin e vendimit të kryetarit nga ana e nëpunësve të QPS - Zyra e cila gjendet në lagjen e minoriteteve dhe marrja e masave administrative ndaj këtyre punëtorëve, grumbullimi i mbeturinave mjekësore dhe barna me afat të skaduar, mos pagesa me kohë e punëtorëve lidhur me honorarët, mos pagesa nga ana e MPMS-së për fëmijë me aftësi të kufizuar deri në moshën 18 vjeçare, mungesa e familjeve strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore në Komunën e Rahovecit, mungesa e barnatoreve kujdestare gjatë natës në qytetin e Rahovecit, janë probleme tjera të cilat i evidenton Drejtoria e Shëndetësisë e Komunës së Rahovecit për vitin 2011.

## 9. Transparenca në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit e ka të themeluar Zyrën për Marrëdhënie me Publikun ku është i punësuar një person dhe kjo zyre funksionon brenda kabinetit të Kryetarit të Komunës. Mediat e shkruara kanë korrespondent nga kjo komunë ku mbulohen zhvillimet e përgjithshme. Sasia dhe cilësia e informatave që këta korrespondentë marrin nga kjo zyre dhe nga dikasteret tjerë komunal vlerësohet përgjithësisht e kënaqshme. Media qendrore elektronike (RTK, KTV dhe RTV21) bëjnë pasqyrime të rralla nga ky lokalitet dhe pasqyrimet e hasura janë kryesisht jashtë natyrës së qeverisjes lokale. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Rahovecit është relativisht mirë e furnizuar me materialet e nevojshme dhe të rëndësishme për opinion. Në këtë ueb faqe hasen raportet financiare vjetore 2010, ajo 2011 si dhe raporti gjashtëmuor i këtij viti. Edhe raporti i punës i kryetarit haset në ueb faqe, ku përfshihen punët e bëra në periudha të ndryshme të vitit nga ana e gjitha Drejtorive komunale si dhe zyrave përkatëse. Ueb faqja i ka në dispozicion edhe të dhënat për shpalljet e bëra nga Zyra e Prokurimit si dhe njoftimet për lidhet e kontratave. Vendimet dhe rregulloret komunale gjitha janë në dispozicion të publikut si dhe disa nga procesverbalet e Kuvendit Komunal.

Në vitin 2012, Instituti GAP ka dërguar kërkesë për qasje në të dhënat e detajuara të shpenzimit të buxhetit të komunës për karburante, dreka zyrtare dhe telefona, dhe kemi marrë përgjigje pozitive.

Tabela: nr.14: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Rahovecit <http://kk.rks-gov.net/rahovec/>

Dokumenti	2010				2011				2012		
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	I I	I I I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	√	x	√	x	√	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	√	x	√		√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	X
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjenca	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Drejtoria për Bujqësi	x	x	x	x	x	x	x	√	x	√	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit					√					√	√
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm					x						
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				√				√	x	x
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.										
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√	√	√
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal					√						
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës					√						

X = mungon raporti, √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Burimet:

1. Komuna e Rahovecit. Raport financiar. Plani i buxhetit për gjashtëmujorin e vitit 2012
2. Komuna e Rahovecit. Raport financiar. Plani vjetor i buxhetit janar-dhjetor 2011
3. Komuna e Rahovecit. Raporti i punës për gjashtëmujorin e vitit 2012
4. Komuna e Rahovecit. Raporti i punës për vitin 2011
5. Komuna e Rahovecit. Plani vjetor i punës për vitin 2012
6. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011 <http://mf.rks.gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqtendrore.aspx>
7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011  
Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
8. Raportet vjetore 2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90)
9. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Lipjanit. - [https://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](https://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
10. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për vitin 2011 për Komunën e Rahovecit.  
Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Rahovec\\_31\\_12\\_2011\\_Final\\_alb\\_928872.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Rahovec_31_12_2011_Final_alb_928872.pdf)
11. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Regjistrimi i Popullsisë dhe ndikimi i tij në Politikat Publike.  
Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/GAPanalizepertedhenateASK.pdf>
12. Komuna e Rahovecit. Lista e të punësuarëve në Administratën komunale -2012
13. Komuna e Rahovecit. Web faqja zyrtare e komunes. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/rahovec/>